



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 461/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Avdi Smajlaj, sekretar i Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Aleanca Kosova e Re.

A r s y e t i m

Avdi Smajlaj nga radhët e subjektit politik AKR dega në Prishtinë ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke pretenduar se në shkollën fillore “Dardania” në Qendrës Votimit 1904 militantët e LDK-së kanë qëndruar në korridore të shkollës për ti orientuar votuesit se ku të votojnë dhe se policia nuk ka ndërmarrë asgjë.

Më 12 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga AKR, duke pretenduar se militantët e subjekti politik LDK, kanë shkaktuar parregullsi gjatë procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar

Prandaj duke e shqyrtuar dhe analizuar ankesën e AKR-së përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave për t'u bindur se militantët e LDK-së kanë shkaktuar parregullsi dhe se nuk kanë ofruar asnjë prova si dëshmi bindëse për parregullësin e pretenduar. PZAP-i konsideron që AKR nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë

A nr. 461/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

